

Agjensia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) kërkon të punësojë personel civil, të cilët të kenë kryer studimet e larta në degët: teknologji informacioni, inxhinieri elektronike, inxhinieri telekomunikacioni, dhe inxhinieri mekanike.

Aplikimi për punësim në AISM, do të bëhet në mënyrë elektronike sipas formularit bashkëlidhur dhe të dërgohet në adresën e-mail; hr6002@mod.gov.al .

Afati i aplikimit deri me datë 30.05.2019.

Kriteret dhe dokumentacioni.

I. Kriteret:

- 1) të jetë vetëm shtetas shqiptar;
- 2) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 3) të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor;
- 4) të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- 5) të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- 6) të mos jetë larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike;
- 7) të plotësojë kushtin e sigurisë;
- 8) të mos ketë filluar ndjekja penale ndaj tij;
- 9) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të detyrës në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- 10) të mos ketë konflikt interesi me detyrën ose funksionin që do të kryejë.
- 11) të ketë qëndrim jo më pak se 5 vitet e fundit në Shqipëri, përjashtuar personin që është dërguar jashtë shtetit në përfaqësi ose mision ushtarak apo diplomatik, si dhe për studime nga Ministria e Mbrojtjes ose nga institucione të tjera shtetërore, që kanë objekt të veprimtarisë së tyre çështje të sigurisë ose të mbrojtjes.

II. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen për procedim të mëtejshëm, do të njoftohen dhe në datën e caktuar duhet të paraqesin dokumentacionin (Hard copy) e mëposhtëm;

- 1) Kërkesë personale për punësim në AISM;
- 2) Jetëshkrimi (Curriculum Vitae);
- 3) Fotokopje të diplomës, dëftesës së pjekurisë dhe listën e notave të noterizuara;
- 4) Fotokopje të letërnjoftimit ID e firmosur nga vetë personi;
- 5) Certifikatë familjare;
- 6) Raport mjeko-ligjor;
- 7) Vërtetim nga gjykata;
- 8) Vërtetim nga prokuroria;
- 9) Vërtetim nga Zyra e Përmbarimit;
- 10) Dëshmi Penaliteti;
- 11) Librezë pune (fotokopje);

- 12) Vlerësime pune (nga institucionet ku ka punuar më parë, nëse ka qenë i punësuar);
- 13) Fotokopje të certifikatave (diplomave) të kualifikimeve të kryera, trajnimeve, kurseve të ndryshme si dhe të gjuhës së huaj;
- 14) Katër fotografi me përmasa 2 (dy) cope 4x6 dhe 2 (dy) copë 9x12;
- 15) Formularin e vetëdeklarimit i cili gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën elektronike www.mod.gov.al (linku; Baza ligjore/akte ligjore/Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetëdeklarimit).

Shënim:

- *Kandidatët e përzgjedhur do të nënshtrohen procesit të konkurimit (testim dhe intervistë).*
- *Preferencë do të kenë kandidatët me notë mesatare të arsimit të lartë mbi 7 dhe notë mesatare të arsimit të mesëm mbi 8.*
- *Kandidatët preferohen të kenë nivel të mirë dhe shumë të mirë të njohurive në gjuhën angleze të njohur nga institucionet shtetërore si dhe gjuhë të dyta të rralla.*